

Rishikimi i Prodhimit të Brendshëm Bruto, 2024

Tiranë, më 27 Shtator 2024: Instituti i Statistikave (INSTAT), në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Politikën e Harmonizuar Evropiane për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike (HERP – eng, [Practical guidelines for revising ESA 2010 data — 2019 edition - Products Manuals and Guidelines - Eurostat \(europa.eu\)](#) link: Data revision - ESA 2010 - Eurostat (link: [Data revision - Eurostat \(europa.eu\)](#)), publikon seritë e përditësuara kohore të Llogarive Kombëtare, 2018 – 2023*, në kuadër të Rishikimit thelbësor të treguesve të llogarive kombëtare, i cili sikurse ishte bërë i ditur publikisht do të realizohej në Shtator 2024.

Si rezultat i përmirësimeve, rishikimi i serive kohore 2018 – 2023, ka ndikuar në nivelin e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke rezultuar në ndryshim në terma nominal 2,48 % në vitin 2023 krahasuar me vlerësimet e mëparshme, të cilat bazoheshin në vlerësimet tremujore të PBB - së..

Tabela 1. Prodhimi i Brëndshëm Bruto, në vlerë nominale me çmime korrente, 2018–2023*

Vitet	PBB-para rishikimit Milion lekë	PBB e rishikuar Milion lekë	Diferenca Në %
2018	1,636,731	1,660,820	1.47
2019	1,691,903	1,712,037	1.19
2020	1,647,431	1,655,985	0.52
2021	1,856,172	1,866,674	0.57
2022	2,138,339	2,149,742	0.53
2023*	2,312,591	2,369,906	2.48

2023* Të dhëna gjysmëfinale

Rritja reale e PBB-së për vitin 2023, vlerësohet 3,94 % nga 3,45% e publikuar më parë nga vlerësimet e PBB-së tremujore. .

Tabela 2. Rritja reale e Prodhimit të Brëndshëm Bruto, 2018-2023*

Vitet	PBB-para rishikimit, në %	PBB e rishikuar, në %
2019	2.09	2.06
2020	-3.30	-3.31
2021	8.91	8.97
2022	4.86	4.83
2023*	3.45	3.94

2023* Të dhëna gjysmëfinale

Për publikim 27/09/2024

Vijon

Në kuadër të rishikimit të Llogarive Kombëtare, vlerësohet për herë të parë Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), me metodën e të ardhurave. Në strukturën e PBB-së sipas kësaj metode, komponentët kryesorë janë fitimi operativ bruto (B.2g), i cili përbën peshën kryesore të të ardhurave në ekonomi, me 61,49% në vitin 2023*. Kompensimi i punonjësve (D1), zë 24,34%, i ndjekur nga taksat mbi produktet me 12,82% për të njëjtin vit.

Tab.3: Treguesit e Prodhimit të Brendshëm Bruto, sipas metodës të të Ardhurave, 2018–2023*, në milion lekë

Kodi ESA 2010	Treguesit	2018	2019	2020	2021	2022	2023*	Struktura në PBB (%)
D.1	Kompensimi i punonjësve	395,889	430,981	428,199	485,251	527,955	576,891	24.34
D.2	Taksa mbi prodhimin dhe importet	253,586	256,924	222,835	299,185	325,118	337,108	14.22
D.3	Subvencione	-557	-749	-483	-321	-1,424	-1,344	-0.06
B.2g/B.3g	Fitimi operativ bruto / Të Ardhura mikse bruto	1,011,902	1,024,879	1,005,434	1,082,558	1,298,092	1,457,251	61.49
B.1g	Prodhimi i Brendshëm Bruto	1,660,820	1,712,035	1,655,985	1,866,674	2,149,741	2,369,906	100.00

2023* Të dhëna gjysmëfinale

Shpjegim metodologjik mbi rishikimin

Rishikimet madhore janë procese të rregullta të sistemit të Llogarive Kombëtare, të cilat kryhen të paktën një herë në 5 vjet, në mënyrë të koordinuar dhe në bashkëpunim me Eurostat. Ato kanë si qëllim përfshirjen e burimeve të reja të informacionit, përmirësimin e burimeve ekzistuese si dhe zbatimin e ndryshimeve metodologjike statistikore ndërkombëtare. Rishikimi i mëparshëm i Llogarive Kombëtare u krye në vitin 2014, kur INSTAT për herë të parë u bë pjesë e ciklit të rishikimit sipas standardeve të BE-së. Rishikimi i vitit 2024 është rishikimi i dytë i Llogarive Kombëtare dhe përfshin rishikimin e të dhënave që nga viti 2018.

Rishikimi i llogarive kombëtare ka ndikuar në të dhënat statistikore për të gjitha llojet e aktiviteteve (seksionet NACE Rev.2) dhe ato të sektorëve institucionalë të vlerësuar deri tani në baza eksperimentale.

Rishikimi i vitit 2024 konsiston në:

- Përdorimin e tabelave që tregojnë nga vijnë burimet ekonomike dhe si shfrytëzohen për të përmirësuar llogaritjet ekonomike;
- Integrimin për herë të parë të sistemit të Llogarive të Sektorëve Institucionalë në sistemin e Llogarive Kombëtare;

- Përmirësime metodologjike në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare, të realizuara pas vitit 2014, nën asistencën e Bashkimit Evropian, nëpërmjet projekteve IPA shumë përfituese dhe Eurostat në fushën e Llogarive Kombëtare, duke implementuar metodën nga poshtë-lart në vlerësimin e sektorëve institucionalë;
- Përmirësime të burimeve të të dhënave, integrimin e tyre dhe aplikimin e metodave të reja në vlerësimin e treguesve për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme;
- Rritje të cilësisë, nivelit të krahasueshmësi dhe përputhshmërisë së treguesve statistikore;
- Rritje e plotshmërisë së tabelave të publikuara në faqen zyrtare dhe të transmetuara në Eurostat treguesve;
- Përmirësim të afateve kohore në përputhje me Programin e transmetimit ESA 2010.

Përdorimi i tabelave Burim-Përdorim

Përdorimi i tabelave Burim-Përdorim ka sjelle efekte në vlerësimin e Llogarive Kombëtare. Mbështetur në standardet Evropiane të Llogarive (ESA 2010), përdorimi i tabelave Burim-Përdorim në vlerësimin e treguesve të llogarive kombëtare mundëson jo vetëm integrimin e të gjitha burimeve të të dhënave në një sistem të vetëm por siguron vlerësimin përfundimtar të Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)-së me tre metodat e vlerësimit, me atë të prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave.

Ndryshimet në rishikimin e vlerësimit të Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) janë:

- Vlerësimi i Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)-së me Metodën e të Ardhurave;
- Balancimi dhe vlerësimi i Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)-së me metodën e prodhimit, metodën e shpenzimeve dhe atë të të ardhurave duke eliminuar mospërputhjet statistikore.

Integrimi i Llogarive të Sektorëve Institucionalë:

INSTAT përpiloi setin e plotë të llogarive jofinanciare sipas pesë sektorëve kryesorë institucionalë:

- Korporatat Jo Financiare;
- Korporatat Financiare;
- Qeveria e Përgjithshme;
- Ekonomitë Familjare ;
- Institucionet Jo-Fitimprurëse që u shërbejnë familjeve.

Përpilimi i Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)-së dhe sipas sektorëve institucionalë mundëson krijimin e një tabloje më të qartë të ekonomisë dhe ndërveprimeve të të gjithë komponentëve të saj.

Përmirësimet metodologjike, burime të dhënash

- a. Përmirësime në metodat e vlerësimit të ekonomisë së vrojtuar për Seksionin “Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve” të cilat përfshijnë:
 - riklasifikim të njësive institucionale kryesisht të njësive të cilat i përkasin formës ligjore “Person Fizik” dhe kryejnë aktivitete ndihmëse si zyra këmbimi valuator, ndërmjetës të tjerë për sigurime dhe shërbime të tjera ndihmëse. Vlerësimi është bazuar në informacionin e marrë nga pasqyrat financiare dhe është pjesë e Sektorit të Familjeve (S.14);
 - përmirësime metodologjike duke përmirësuar vlerësimin e prodhimit, konsumit të ndërmjetëm dhe vlerën e shtuar për aktivitetin NVE 65;
 - përmirësim i metodës së vlerësimit të aktivitetit të “Shoqatave jofitimprurëse në shërbim të familjeve” duke zbatuar metodën e kostos;
 - përfshirjen e rregullimeve konceptuale në vlerësim.
- b. Përmirësim i konceptit të gjithpërfshirjes në Llogaritë Kombëtare, duke u mbështetur në rekomandimet e EUROSTAT mbi vlerësimin e Ekonomisë së Pavrojtuar, sipas metodës “Tabular Approach”. Përmirësimet konsistojnë kryesisht në vlerësimin e komponentëve të rinj të papërfshirë më parë si dhe në zgjerimin e komponentëve ekzistues, duke reflektuar burime të reja informacioni.
- c. Përmirësime në vlerësimin e Shpenzimeve për Konsum Final të Familjeve si rezultat i integritit të plotë të tabelave Burim - Përdorime në Llogaritë kombëtare. Procesi i balancimit mundësoi një analizë më të detajuar të ndikimit të kërkesës së familjeve për produkte të ndryshme nga ana e burimeve dhe ndikoi në krijimin e një pamje më qartë të ndërveprimeve midis sektorëve ekonomikë. Vlerësimet e vitit 2019 janë përdorur për benchmarkimin* e këtij treguesi.
- d. Përmirësimet në vlerësimin e komponentit “Formimi Bruto i Kapitalit Fiks” (FBKF), përfshijnë vlerësimin e “Softuer” me metodën e kostos së punës. Kjo metodë lejon një vlerësim më të saktë të kontributit të sektorit të teknologjisë së informacionit në ekonominë kombëtare, duke marrë parasysh të dhënat për pagat dhe kostot e punës. Të gjitha përmirësimet rezultuan në përpilimin e një vlerësimi më të detajuar të Formimit Bruto të Kapitalit Fiks (FBKF) sipas llojit të aseteve.

Përmirësimet metodologjike dhe i burimeve të informacionit kanë impaktuar vlerësimin treguesve së Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)-së me të tre metodat dhe llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucional.

Përmirësime në vlerësimin e Sektorit i Qeverisjes së Përgjithshme (S.13)

- a. Pjesë e rishikimit të Llogarive kombëtare janë dhe përmirësimet në vlerësimin e Sektorit i Qeverisjes së Përgjithshme (S.13) të cilat përfshijnë:

- Klasifikimi i Sektorit Publik në Shqipëri sipas ESA 2010/GFSM 2014. Në vlerësimin e sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme përfshihen të gjitha njësitë buxhetore dhe njësitë e klasifikuara si njësi ekstra-buxhetore, të cilat janë integruar në vlerësimet e treguesve të Llogarive Kombëtare;
 - Rishikimi i llogarive të qeverisë të raportuara nga Ligji Organik i Buxhetit për klasifikimin e tyre në kodet ESA 2010/GFSM2014 dhe përditësimi i klasifikimit të llogarive ekonomike të njërive ekstra-buxhetore (EBU) tashmë pjesë e sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme ka sjellë ndryshim në treguesit e taksave dhe subvencioneve mbi produktet.
- b. Riklasifikimi i aktivitetit ekonomik të disa prej institucioneve të sektorit publik;
- c. Përfshirja e njërive ekstra-buxhetore në vlerësimet e sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme, ka ndikuar në vlerësimin e treguesve ekonomik të këtij sektori;
- d. Përmirësime në lidhje me metodat e përdorura në vlerësimin e konsumit të kapitalit fiks, detyrimeve të prapambetura dhe përfshirjen e konceptit “time adjusted cash”.

Viti bazë

Gjatë rishikimit madhor, viti bazë për serinë kohore të PBB-së të lidhur me zinxhir ndryshohet në të gjithë Evropën. Viti bazë i mëparshëm 2015 zëvendësohet nga viti 2020 si viti i ri bazë. Ky ndryshim nuk ndikon në tendencat apo normat e rritjes së PBB-së; vetëm niveli nominal i serisë kohore të lidhur me zinxhir ndryshon.